



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Nr. 740 Akti

Nr. 815 Vendimi
Tiranë, 21.11.2024

V E N D I M

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, i përbërë nga:

Olsi Komici Kryesues
Suela Zhegu Relatore
Brunilda Bekteshi Anëtare

asistuar nga sekretarja gjyqësore, znj. Etmonda Hoxha, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Gerrit Sprenger, në datën 21.11.2024, ora 14:00, në Pallatin e Koncerteve (ish-Pallati i Kongreseve), salla B, kati 0 (*underground*), Tiranë, mori në shqyrtim në seancën dëgjimore publike çështjen që i përket:

SUBJEKTI I RIVLERËSIMIT: **Znj. Marjola Beluli**, ndihmëse ligjore në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Vlorë, aktualisht gjyqtare në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës.

OBJEKTI: Rivlerësimi kalimtar i subjektit të rivlerësimit.

BAZA LIGJORE: **Pika 5 e nenit 179/ b të Kushtetutës, pika 1 e nenit Ç dhe nenet D, DH dhe E të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë**, miratuar me ligjin nr. 76/2016, datë 22.7.2016 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998 “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar;

Ligji nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”;

Ligji nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”;

Ligji nr. 49/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”.

TRUPI GJYKUES I KOMISIONIT TË PAVARUR TË KUALIFIKIMIT,

pasi dëgjoi arsyetimin ligjor dhe rekomandimin e relatores së çështjes, mori në shqyrtim dhe analizoi provat shkresore të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit kryesisht, shqyrtoi të gjithë dokumentacionin e administruar në dosjen e hetimit, si dhe analizoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I. FAKTET DHE RRETHANAT E ÇËSHTJES

1. Subjekti i rivlerësimit, znj. Marjola Beluli, aktualisht gjyqtare pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës, në bazë të pikës 3 të nenit 179/b të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë i është nënshtruar rivlerësimit *ex officio*, duke u shortuar si subjekt me shortin e hedhur në datën 15.6.2021, në përputhje me rregulloren “Për procedurat e zhvillimit të shortit në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit”.
2. Trupi gjykues i shortuar për të shqyrtuar çështjen përbëhet nga komisionerët Suela Zhegu me cilësinë e relatores, Olsi Komici kryesues dhe Brunilda Bekteshi anëtare. Në mbledhjen e trupit gjykues të datës 15.6.2021 u caktua me mirëkuptim kryesues i trupit gjykues komisioneri Olsi Komici. Në respektim të legjislacionit në fuqi mbi parandalimin e konfliktit të interesit u deklarua mospasja e konfliktit të interesit nga anëtarët e trupit gjykues, si dhe u vendos fillimi i hetimit administrativ nga relatorja e çështjes. Subjekti i rivlerësimit u njoh me anëtarët e trupit gjykues dhe deklaroi mospasjen e konfliktit të interesit me komisionerët. Vëzhgues ndërkombëtar për këtë subjekt rivlerësimi është caktuar z. Gerrit Sprenger.
3. Procesi i rivlerësimit të pasurisë për subjektin e rivlerësimit, në përputhje me kreun IV “Vlerësimi i pasurisë” të ligjit nr. 84/2016 dhe veçanërisht me nenin 30 të këtij ligji, ka për objekt vlerësimin, deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të ligjshmërisë së burimit të krijimit të tyre, të përmbushjes së detyrimeve financiare, përfshirë interesat privatë për subjektin e rivlerësimit dhe për personat e lidhur me të.
4. Bazuar në nenet 33, 39 dhe 43 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit janë administruar raportet e hartuara nga institucione, si: Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në vijim ILDKPKI); Autoriteti Kombëtar për Sigurinë e Informacionit të Klasifikuar (në vijim AKSIK); Këshilli i Lartë Gjyqësor (në vijim KLGJ).
5. ILDKPKI-ja, në përputhje me nenin 33 të ligjit nr. 84/2016, pasi ka kryer një procedurë kontrolli për vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit, ka dërguar një raport të hollësishëm dhe të arsyetuar¹, duke konkluduar se:
 - *deklarimi është i saktë në përputhje me ligjin;*
 - *ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë;*
 - *nuk ka kryer fshehje të pasurisë;*

¹ Me shkresën nr. *** prot., datë 29.3.2018.

- *nuk ka kryer deklarim të rremë;*
 - *subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.*
6. AKSIK-ja ka kryer kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit me anë të verifikimit të deklarimeve dhe të dhënave të tjera, me qëllim që të identifikonte nëse subjekti i rivlerësimit ka kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës dhe në ligjin nr. 84/2016, si dhe ka dërguar një raport të arsyetuar për subjektin e rivlerësimit, znj. Marjola Beluli.
 7. KLGJ-ja ka kryer vlerësimin e aftësive profesionale, duke rishikuar dokumentet ligjore të përpiluara nga subjekti i rivlerësimit gjatë periudhës objekt rivlerësimi, sipas shtojcës 4 të ligjit nr. 84/2016, pesë dokumentet e tjera ligjore të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor, si dhe ka dërguar një raport të hollësishëm dhe të arsyetuar² mbi subjektin e rivlerësimit.
 8. Në vijim, relatorja e çështjes ka ndjekur procedurat ligjore të përcaktuara në pikën 5 të nenit 14 të ligjit nr. 84/2016. Procesi i rivlerësimit ka nisur me një hetim administrativ të thellë dhe të gjithanshëm, me qëllim vlerësimin e të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për këtë procedurë rivlerësimi.
 9. Trupi gjykues, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, pasi u njoh me raportin dhe rekomandimin e relatores së çështjes në datën 8.11.2024, vendosi përfundimin e hetimit kryesisht për subjektin e rivlerësimit Marjola Beluli dhe njoftimin e subjektit për t'u njohur me materialet e dosjes, dokumentet e administruara nga Komisioni dhe rezultatet paraprake të hetimit në përputhje me nenet 35 - 40 dhe 45 - 47 të Kodit të Procedurave Administrative, si dhe duke i kaluar subjektit të rivlerësimit barrën e provës në përputhje me nenin 52 të ligjit nr. 84/2016 dhe nenin D të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.
 10. Subjekti Marjola Beluli, pasi u njoh me rezultatet e hetimit, ka paraqitur shpjegimet dhe provat në datën 19.11.2024. Trupi gjykues, pas shqyrtimit të këtyre shpjegimeve dhe provave të vëna në dispozicion nga subjekti, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, vendosi të ftojë subjektin e rivlerësimit në seancën dëgjimore të datës 21.11.2024.
 11. Për një proces të rregullt ligjor, subjektit të rivlerësimit Marjola Beluli i janë garantuar të drejtat: (i) për t'u njoftuar për fillimin e procedurës së rivlerësimit; (ii) për t'u njohur me përbërjen e trupit gjykues; (iii) për përfundimin kryesisht të hetimit administrativ, duke i kaluar barrën e provës/shpjegimet mbi rezultatet e hetimit. Subjektit iu dha koha e nevojshme për t'u njohur me dosjen e hetimit dhe për të disponuar kopje të saj, si dhe u njoh me rezultatet paraprake të hetimit administrativ.

II. SEANCA DËGJIMORE

12. Seanca dëgjimore u zhvillua në datën 21.11.2024, në përputhje me kërkesat e nenit 55 të ligjit nr. 84/2016, në ambientet e Pallatit të Koncerteve, salla B, kati 0 (*underground*), Tiranë, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Gerrit Sprenger.

² Me shkresën nr. *** prot., datë 29.10.2024.

13. Në seancën dëgjimore, subjekti i rivlerësimit Marjola Beluli u paraqit dhe u mbrojt personalisht, si dhe shprehu opinionin e saj në lidhje me procesin e rivlerësimit të kryer. Në përfundim, subjekti i rivlerësimit pranoi rezultatet e hetimit të kryera nga Komisioni dhe kërkoi konfirmimin në detyrë.

III. QËNDRIMI DHE MENDIMI I SUBJEKTIT TË RIVLERËSIMIT

14. Subjekti i rivlerësimit Marjola Beluli ka qenë bashkëpunuese gjatë procesit të rivlerësimit, në zbatim të nenit 48 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” gjatë gjithë procedurës së hetimit administrativ, si dhe ka zbatuar me përpikëri afatet e përcaktuara nga Komisioni. Znj. Beluli ka qenë e gatshme për bashkëpunim gjatë të gjitha fazave të hetimit, si dhe gjatë zhvillimit të seancës dëgjimore.

IV. PROCESI I RIVLERËSIMIT/HETIMI I KRYER NGA KOMISIONI

15. Procesi i rivlerësimit, që kryhet nga Komisioni, është një proces kushtetues që mbështetet në nenin 179/b dhe në Aneksin e Kushtetutës, si dhe në ligjin nr. 84/2016. Ky proces kryhet me qëllim që të garantohet funksionimi i shtetit të së drejtës, pavarësia e sistemit të drejtësisë, me synim rikthimin e besimit të publikut tek institucionet e këtij sistemi.
16. Parashikimet e ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” kanë përcaktuar qartë të gjitha rregullat e posaçme për kryerjen e rivlerësimit mbi bazën e parimeve të barazisë përpara ligjit, të kushtetutshmërisë dhe ligjshmërisë, të proporcionalitetit dhe të parimeve të tjera, që garantojnë të drejtën e subjekteve të rivlerësimit për një proces të rregullt ligjor.
17. Sipas kreut IV të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, ILDKPKI-ja është organi kompetent shtetëror i ngarkuar me ligj për të bërë vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit dhe për të marrë vendim në lidhje me vlerësimin pasuror.
18. Ndërsa sipas kreut V të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, AKSIK-ja është organi kompetent shtetëror i ngarkuar me ligj për të bërë vlerësimin e figurës dhe për të marrë vendim në lidhje me kontrollin e figurës.
19. Referuar vendimit nr. 2/2017 të Gjykatës Kushtetuese dhe kreut VII të ligjit nr. 84/2016, ka rezultuar se Komisioni në kryerjen e funksionit të tij kushtetues realizon një proces të mirëfilltë kontrolli dhe rivlerësimi, që nuk bazohet dhe as është i detyruar nga përfundimet e paraqitura nga organet e tjera ndihmëse.
20. Bazuar në nenet 45, 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni kreu hetimin dhe vlerësimin e të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për procedurën e rivlerësimit, duke marrë në analizë:
- a. provat e dorëzuara nga subjekti në ILDKPKI me deklaratën e pasurisë për rivlerësimin kalimtar *Vetting*;

- b. raportin e dorëzuar në Komision nga ILDKPKI-ja;
- c. deklaratën e rivlerësimit kalimtar *Vetting* dhe deklaratat periodike/vjetore të dorëzuara ndër vite nga subjekti në ILDKPKI;
- ç. provat shkresore/dokumentet e administruara nga organet publike dhe private;
- d. raportin e kontrollit të figurës të dorëzuar në Komision nga AKSIK-ja;
- dh. raportin për vlerësimin e aftësive profesionale të dorëzuar në Komision nga KLGJ-ja;
- e. deklaratimet e subjektit të rivlerësimit me anë të komunikimit elektronik;
- ë. shpjegimet me shkrim të subjektit të rivlerësimit të depozituar nëpërmjet postës elektronike dhe ato gjatë seancës dëgjimore për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit.

21. Bazuar në nenin 179/b, në nenet Ç, D, DH dhe E të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe në ligjin nr. 84/2016, procesi i rivlerësimit për subjektin e rivlerësimit Marjola Beluli, me detyrën e ndihmëses ligjore në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Vlorë, aktualisht gjyqtare pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës, u krye mbi bazën e tri kriterëve: vlerësimi i pasurisë, kontrolli i figurës dhe vlerësimi i aftësive profesionale.

A. RIVLERËSIMI I PASURISË NGA KOMISIONI

22. Komisioni, bazuar në ligjin nr. 84/2016, kreu një hetim administrativ të thelluar dhe të gjithanshëm, i cili konsistoi në verifikimin e vërtetësisë së deklaratimeve në lidhje me gjendjen pasurore, burimet e krijimit të kësaj pasurie, të ardhurat, shpenzimet, si dhe mundësinë për fshehje të pasurisë dhe deklarim të rremë apo konflikt interesi.

23. Ky hetim është përqendruar mbi të gjitha pasuritë e deklaruara nga znj. Marjola Beluli në deklaratën e pasurisë, shtojca 2, dorëzuar në ILDKPKI në zbatim të ligjit nr. 84/2016, ku subjekti ka deklaruar pasuritë:

24. Apartament banimi me sip. 56.5 m², me adresë lagjja “*** Maji”, Pall. ***, apt. **, kati *, Vlorë, blerë në vitin 2003, në bashkëpronësi me nënën e saj, me vlerë të deklaruar shumën 1.103.987 lekë.

24.1 Burimi i krijimit të kësaj pasurie është sipas VKM-së nr. 413, datë 19.6.2003, nr. rendor **, “Për kalimin e banesave të ndërtuara në qytetin e Vlorës në pronësi të banorëve të shpërngulur nga fshati M, Vlorë”.

24.2 Subjekti për pasurinë me nr. ***, z. k. ***, ka deklaruar se është përfituar me kontratë shitblerjeje me pagesë të menjëhershme me nr. *** rep., *** kol., datë 10.11.2003.

Hetimi i Komisionit

24.3 ASHK-ja Vlorë³ ka konfirmuar* se znj. Marjola Beluli (D) ka të regjistruar pasurinë me nr. ***, vol. **, fq. **, në z. k. ***, të llojit apartament, me sip. 56.4 m², në bashkëpronësi me shtetasen L.D.

³ Me e-mailin e datës 29.3.2017, drejtuar ILDKPKI-së.

24.4 FSHU-ja⁴ ka informuar se në emër të shtetases L.D, referuar të dhënave të sistemit të faturimit, identifikohet një abonent me kontratë furnizimi në instancën e Vlorës.

Analiza e fakteve

24.5 Nga aktet e dosjes së subjektit të rivlerësimit rezulton një kontratë shitjeje apartamenti banimi, me pagesë të menjëhershme me nr. *** rep., nr. *** kol., datë 10.11.2003, vlerë 1.103.987 lekë. Në këtë kontratë palë shitëse rezulton Enti Kombëtar i Banesave Vlorë dhe palë blerëse L.D kryefamiljare dhe M.D, e bija, si dhe vërtetimi hipotekor nr. *, datë 31.7.2003, harta treguese dhe certifikata familjare. Në kontratë citohet se vlera e apartamentit ndërtuar/blerë me fonde shtetërore është në shumën 1.103.987 lekë. Në pikën 6 të kontratës është parashikuar se blerësi e ka përfituar falas këtë apartament, sipas VKM-së nr. 413, datë 19.6.2003.

24.6 Në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 413, datë 19.6.2003 “Për kalimin e banesave të ndërtuara në qytetin e Vlorës në pronësi të banorëve të shpërngulur nga fshati M, Vlorë”, në paragrafin e parë të tij është parashikuar: *“Me këtë akt vendoset kalimi i banesave të ndërtuara në qytetin e Vlorës në pronësi të banorëve të shpërngulur nga fshati M, Vlorë, sipas listës emërore të miratuar nga këshilli i komunës V, që i bashkëlidhet këtij vendimi. Kalimi në pronësi të bëhet pa pagesë”*.

24.7 Bashkëlidhur VKM-së është lista emërore e banorëve të fshatit M që përfitojnë strehim në qytetin e Vlorës, dhe me nr. rendor ** rezulton znj. L.D (nëna e subjektit të rivlerësimit), e cila ka përfituar një apartament 1+1.

24.8 Nga sa më sipër, rezulton se përputhet deklarimi i subjektit me dokumentacionin e dorëzuar dhe përgjigjen e ardhur nga ASHK-ja Vlorë.

25. Tokë bujqësore me sip. 37.000 m², në fshatin M, Vlorë, e përfituar në bazë të AMTP-së nr. ***, në emër të kryetarit të familjes bujqësore, z. Z.D, me sip. 37.000 m².

25.1 Subjekti i rivlerësimit ka përfituar 1/7-ën e sipërfaqes prej 37.000 m², pasi kanë qenë shtatë anëtarë. Kjo pasuri e deklaruar nga subjekti është pasuri e përfituar në bazë të ligjit nr. 7501/1991 “Për tokën”, i ndryshuar. Pjesa takuese e subjektit: 14.2%.

Hetimi i Komisionit

25.2 ASHK-ja Vlorë⁵ ka konfirmuar se fshati M, Njësia Administrative K, është zonë e pamenaxhuar, e cila nuk i është nënshtruar regjistrimit fillestar sistematik, për këtë arsye zyra nuk ka informacion në lidhje me pasuritë e paluajtshme në këtë zonë.

Për pasurinë tokë bujqësore e deklaruar nga subjekti si e përfituar me AMTP-në nr. 7694, nuk ngrihen dyshime nga ana e Komisionit.

26. Llogari page në shumën 14.840,26 lekë, në datën 27.1.2017

⁴ Me shkresën nr. *** prot., datë 22.5.2023.

⁵ Me e-mailin e datës 29.3.2017, drejtuar ILDKPKI-së.

26.1 Tirana Bank⁶ ka konfirmuar se subjekti Marjola Beluli ka pasur llogari page për periudhën 2008 – 2022.

26.2 Për sa më sipër, përputhet deklarimi i subjektit me dokumentacionin e dorëzuar, si dhe me përgjigjen e Tirana Bank.

DETYRIME FINANCIARE

27. Kredi bankare e marrë për arsye shëndetësore, në shumën 700.000 lekë. Data e fillimit 16.12.2016, datë mbarimi 15.12.2021; normë efektive e interesit 9.76%; kohëzgjatja e kredisë 60 muaj; kësti mujor 14.949 lekë; shuma e detyrimit të mbetur 690.692,32 lekë.

28. *Overdraft* i marrë për konsum në shumën 45.000 lekë. Data e fillimit 25.1.2017, datë mbarimi 25.1.2018; Nr. kontrate nuk ka, datë 25.1.2017; norma e interesit 9.7% në vit; kësti mujor 39.000 lekë.

28.1 Tirana Bank⁷ ka konfirmuar se znj. Marjola Beluli dhe z. E.A.B kanë qenë bashkëhuamarrës. Gjendja e detyrimit në datën 27.1.2017 është në vlerën 690.692,32 lekë. Gjithashtu, kjo bankë nuk e ka konfirmuar se Marjola Beluli ka pasur *overdraft*.

28.2 Përputhet deklarimi i subjektit me dokumentacionin e dorëzuar dhe me përgjigjen e Tirana Bank.

DEKLARIMI I BASHKËSHORTIT TË SUBJEKTIT, E.B

Deklarimi i pasurive

29. Nga administrimi i akteve ka rezultuar se subjekti ka lidhur martesë me shtetasin E.B në datën 24.10.2014. Referuar vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, me nr. 512, datë 28.3.2017, rezulton se subjekti i rivlerësimit e ka zgjidhur martesën me shtetasin E.B në këtë datë.

30. Në deklaratën *Vetting*, depozituar në datën 27.1.2017, shtetasi E.B ka deklaruar pasuritë që dispononte 100% në pronësi të tij, si vijon:

31. **Kamion tip “Scania”**, me targë VL *** C, prodhim i vitit 2004, blerë në shumën 900.000 lekë;

32. **Automjet tip “FLIEGL/180”**, ngjyrë e bardhë, vit prodhimi 1999, me targë VL *** C, blerë në shumën 4.000 euro.

32.1 Bashkëshorti i subjektit ka deklaruar për të dyja automjetet se janë blerë me të ardhurat e përfituara sipas aktmarrëveshjes “Për shitjen e pasurisë së paluajtshme banesë 1-katëshe”, me nr. *** rep., nr. *** kol., datë 13.4.2005.

Hetimi i Komisionit

32.2 DPSHTRR-ja⁸ ka konfirmuar se z. E.B ka pasur të regjistruar automjetin me targë AA *** UX, kamion tip “Scania”, si dhe automjetin tip “FLIEGL/180” me rimorkio për transport mallrash, ngjyrë e bardhë, vit prodhimi 1999. Z. E.B të dyja këto automjete i ka shitur në datën 6.2.2019.

⁶ Me shkresën nr. *** prot., datë 12.5.2023.

⁷ Me shkresën nr. *** prot., datë 12.5.2023.

⁸ Me shkresën nr. *** prot., datë 22.5.2023.

Burimi i krijimit

32.3 Shtetasi E.B ka deklaruar se për blerjen e këtyre automjeteve janë përdorur të ardhurat që burojnë nga aktmarrëveshja “Për shitjen e pasurisë së paluajtshme banesë 1-katëshe” me nr. *** rep., *** kol., datë 13.4.2005, në shumën 4.300.000 lekë. Palë shitëse në këtë kontratë rezulton se është znj. Z.B, e cila në datën e nënshkrimit të kontratës ka marrë shumën prej 2.500.000 lekësh, dhe pjesa tjetër do të shlyhej brenda datës 4.9.2005. Nga kontrata rezulton se kjo pasuri ka qenë ndërtim informal dhe e paregjistruar në regjistrin e pasurive të paluajtshme, për pasojë shitësja nuk ka disponuar dokument pronësie.

32.4 Komisioni ka konstatuar se nuk ka rezultuar ndonjë pasuri banesë 1-katëshe me të dhënat e cilësuar në aktmarrëveshjen e mësipërme, regjistruar në emër të znj. Z.B. Gjithashtu, nuk ka të dhëna për regjistrimin e pasurisë së shitur sipas aktmarrëveshjes me nr. *** rep., nr. *** kol., datë 13.4.2005, në emër të blerësit të saj, apo ndonjë veprim juridik i kryer prej palëve si aplikim për t’u pajisur me leje legalizimi për këtë shtëpi të shitur sipas aktmarrëveshjes nr. ***.

32.5 Për Komisionin nuk rezultoi e provuar pronësia e shitëses mbi këtë pasuri, si dhe nuk identifikohet ndonjë transaksion bankar apo mandatpagesë për të.

32.6 Në dosje rezulton gjithashtu një deklaratë noteriale me nr. ** rep., nr. ** kol., datë 26.1.2017, lëshuar nga shtetasi E.B dhe M.B (motra e E), të cilët deklarojnë se E.B ka marrë nga motra dhuratë shumën 1.075.000 lekë në vitin 2005 (pjesa e saj takuese) nga shitja e pasurisë së paluajtshme të shitur në vitin 2005.

32.7 Nga verifikimi i të dhënave bankare të familjes së z. E.B, nuk rezultoi që të ardhurat e krijuara nga shitja sipas kontratës nr. *** rep., *** kol., datë 13.4.2005, të jenë mbajtur në sistemin bankar prej z. E apo nënës së tij.

32.8 Nga faktet evidentohet se kjo pasuri është krijuar nga z. E.B përpara emërimit në të subjektit të rivlerësimit Marjola Beluli në detyrën e ndihmëses ligjore.

Analiza financiare

32.9 Nga analizimi dhe verifikimi i lëvizjeve në llogaritë e nënës së shtetasi E. B, evidentohet se në emër të saj (znj. Z.B) janë depozituar shuma *cash* pa përshkrim në OTP Bank Albania:

- 690.000 lekë në datën 22.8.2005, e cila rezulton e tërhequr po *cash* në disa pjesë deri në datën 24.11.2005;
- 1.400.000 lekë në datën 18.8.2006 dhe janë tërhequr po *cash* më 30.8.2006.

32.10 Gjithashtu, në llogarinë e znj. Z.B në Raiffeisen Bank evidentohet depozitim *cash* i shumës 950.000 lekë në datën 11.9.2006, e cila është mbajtur si depozitë deri në datën 15.3.2007, kur është tërhequr *cash*.

32.11 Subjekti nuk ka depozituar dokumentacion në lidhje me të ardhura të tjera të siguruara në këtë periudhë për z. E.B dhe nga Komisioni nuk ishte e mundur të kryhej një analizë mbi të ardhurat e kësaj periudhe për mundësinë e blerjes së kësaj pasurie apo mbajtja e shumave të tërhequra nga sistemi bankar.

32.12 Për sa më sipër, për pasuritë kamion, të deklaruara nga z. E.B, rezultoi se:

- ✓ Përputhet deklarimi i subjektit me dokumentacionin e dorëzuar dhe përgjigjen e DPSHTRR-së, e cila konfirmon se kamioni me targë VL *** C dhe kamioni me targë VL *** C kanë qenë në pronësi të shtetasit E.B;
- ✓ Nuk provohet me dokumentacion pronësia apo posedimi i shtëpisë së familjarëve të shtetasit E.B mbi pasurinë/banesën 1-katëshe e shitur sipas aktmarrëveshjes nr. *** rep., *** kol., datë 13.4.2005, apo kryerja e ndonjë veprimi juridik si aplikimi për legalizim për këtë pasuri;
- ✓ Nuk provohet regjistrimi i pasurisë 1-katëshe të shitur nga znj. Z.B në emër të z. P.D;
- ✓ Nuk provohet burimi i ligjshëm për blerjen e automjetit me vlerë 900.000 lekë dhe 4.000 euro në vitin 2014;

32.13 Në lidhje me këto konstatime të Komisionit, subjektit iu kalua barra e provës për të provuar të kundërtën, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016 dhe pikës 5 të nenit D të Aneksit të Kushtetutës.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

32.14 Subjekti, në përgjigje të rezultateve të hetimit⁹, ka theksuar faktin se automjeti i blerë nga z. E.B në datën 25.3.2014 i takon periudhës përpara se të martohej me subjektin e rivlerësimit. Martesa mes E.B dhe Marjola Belulit është lidhur më 24.10.2014, pra pasuria në fjalë ka qenë dhe ka mbetur vetjake e z. E.B. Referuar nenit 74 të Kodit të Familjes: *“Bashkësia përbëhet nga: a) pasuria e fituar nga të dy bashkëshortët, së bashku ose veç e veç, gjatë martesës...”*. Ndërsa referuar nenit 77 të këtij Kodi: *“Pasuri vetjake e bashkëshortit që nuk bën pjesë në bashkësi është: a) pasuria, e cila para lidhjes së martesës ishte në bashkëpronësi të bashkëshortit me persona të tjerë ose kundrejt së cilës ai ishte titullar i një të drejte reale përdorimi; b...”*.

32.15 Subjekti ka shpjeguar se pasuria për të cilën i është kaluar barra e provës, është fituar nga shtetasi E.B para martesës së tyre, e si e tillë është pasuri vetjake e tij. Duke mos qenë pjesë e bashkësisë ligjore, subjekti nuk ka përfituar asnjëherë të drejta pronësie apo bashkëpronësie mbi të. Po kështu, për shkak të natyrës së sendit kamion, ai nuk ka qenë asnjëherë në posedimin apo përdorimin e subjektit të rivlerësimit. Ky ka qenë një automjet pune dhe është blerë prej z. E.B për të punuar, i cili dispononte edhe leje drejtimi për këtë lloj automjeti. Automjeti jo vetëm që është blerë nga z. E.B para lidhjes së martesës, por as nuk i ka shërbyer ekonomisë familjare.

32.16 Subjekti ka shpjeguar se automjeti është blerë gjithashtu edhe përpara nisjes së detyrës së subjektit të rivlerësimit si ndihmëse ligjore pranë ish-Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Vlorë. Mjeti është blerë më 25.3.2014, ndërkohë që emërimi i subjektit të rivlerësimit si ndihmëse

⁹ Bashkëlidhur subjekti ka depozituar aktet vijuese:

- kontratë shitblerjeje nr. *** rep., nr. *** kol., datë 17.10.1998 (dokumenti nr. 1).
- aktmarrëveshje nr. *** rep., nr. *** kol., datë 13.4.2005.
- deklaratë noteriale të shtetasve P.D dhe G.D, e datës 9.11.2024.
- leje legalizimi nr. ***, viti 2016, në emër të shtetasit P.D, bashkëlidhur dhe certifikatë familjare.
- akt ekspertimi hartografik, punuar nga ing. hartografe Gj.A, bashkëlidhur dhe vërtetimi i Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Gjirokastër, datë 15.11.2024.
- tri fletë A3, plan rievimi për punime kadastrale, shkalla 1:5000, z. k. nr. ***.

ligjore është bërë më 16.6.2015, çka tregon qartazi se kjo pasuri nuk ka asnjë lidhje me detyrën e saj.

32.17 Në vijim, në lidhje me deklarimin e blerjes së 2 automjeteve prej z. E.B, subjekti ka shpjeguar se megjithëse shitja është kryer përmes dy kontratave të ndryshme, objekt material i blerjes është vetëm një automjet, i formuar nga koka tërheqëse e kamionit dhe nga rimorkioja, e cila nuk është vetëlëvizëse. Këto dy pjesë kanë qenë të markave të ndryshme dhe me targa të ndryshme, për pasojë janë shitur dhe blerë përmes dy kontratave të ndryshme.

Dy pjesët së bashku formojnë të njëjtin automjet, të llojit “kamion për transport mallrash”. Pra, nuk bëhet fjalë për dy automjete të pavarura, por për dy pjesë të të njëjtit automjet transporti mallrash, që për shkak të rregullimeve të Kodit Rrugor regjistrohen veçmas, kanë targa të ndryshme dhe, për pasojë, shiten (blihen) veçmas.

32.18 Në lidhje me burimin e krijimit të automjetit, subjekti ka shpjeguar se z. E.B për krijimin e tyre ka përdorur të ardhurat e përfituara nga shitja e pasurisë së paluajtshme, shtëpi 1-katëshe në Vlorë, me aktmarrëveshjen nr. *** rep., *** kol., datë 13.4.2005.

32.19 Në lidhje me posedimin e banesës njëkatëshe, shtëpi e ndërtuar nga familja e bashkëshortit E.B, subjekti ka shpjeguar se prindërit e tij A.B dhe Z.B, në bazë të kontratës së shitjes nr. *** rep., nr. *** kol., datë 17.10.1998, kanë shitur një apartament që kishin në bashkëpronësi, të fituar përmes procesit të privatizimit të ish-banesave shtetërore, kundrejt çmimit 1.970.000 lekë.

32.20 Dy bashkëshortët me shumën monetare të fituar nga shitja e apartamentit kanë vendosur të ndërtojnë një banesë njëkatëshe. Kjo e fundit, sipas përshkrimit të bërë në aktmarrëveshjen nr. *** rep., nr. *** kol., datë 13.4.2005, ka qenë “*banesë njëkatëshe, konstruksion tulle me çati solete, me përbërje tri dhoma e një kuzhinë, me ambiente jetësore, që kufizohet nga veriu me H. M, nga jugu me L. Ç, nga lindja dhe perëndimi me rrugë, me oborr*”. Në vitin 2005, banesa ka qenë në posedim vetëm të znj. Z.B, pasi bashkëshorti i saj A në vitin 2003 është ndarë nga jeta. Në këtë banesë, znj. Z.B ka jetuar së bashku me dy djemtë e saj, më i vogli prej të cilëve është z. E.B.

32.21 Në vitin 2005, znj. Z.B ka vendosur ta shesë banesën të blerësi P.D sipas aktmarrëveshjes nr. *** rep., nr. kol. ***, datë 13.4.2005, kundrejt çmimit 4.300.000 lekë. Ditën e nënshkrimit të aktmarrëveshjes pala shitëse ka marrë shumën prej 2.500.500 lekësh, që përfaqëson këstin e parë për shitjen. Kësti i dytë do të paguhej më 4.9.2005, ditën që do të dorëzohej banesa. Palët ishin në dijeni se ndërtimi ishte kryer pa leje ndërtimi, por pala blerëse ka marrë përsipër të ndiqte procedurat administrative deri në regjistrimin e banesës në emër të saj.

32.22 Për të provuar faktet e mësipërme, blerësi i kësaj pasurie, z. P.D, ka lëshuar një deklaratë noteriale nr. *** rep., nr. *** kol., datë 9.11.2024, ku deklaroi: “*Më 13.4.2005, unë P.D, në cilësinë e blerësit dhe znj. Z.B, në cilësinë e palës shitëse, kemi nënshkruar një aktmarrëveshje me numër *** rep., me numër *** kol., datë 13.4.2005, për blerjen e një banese njëkatëshe në shumën 4.300.000 lekë. Deklaroj se e kemi likuiduar vlerën e plotë prej 4.300.000 lekësh në momentin e dorëzimit të sendit. Nuk kemi pretendime në lidhje me këtë vlerë, pasi banesa aktualisht është legalizuar dhe është në pronësinë tonë*”.

32.23 Bashkëlidhur deklaratës noteriale ndodhet edhe leja e legalizimit me nr. ***, viti 2016, në emër të shtetasit P.D për legalizimin e një ndërtese 1-katëshe me sipërfaqe 142 m², në lagjen “H. Ç”, Vlorë.

32.24 Subjekti i rivlerësimit, për të provuar që pasuria e shitur nga znj. Z.B është e njëjta me pasurinë e legalizuar nga z. P.D, ka depozituar një akti ekspertimi hartografik privat.

32.25 Nga aktekspertimi rezulton se nga krahasimi i vendndodhjes së pasurisë sipas kufijve të referuar në aktmarrëveshjen nr. *** rep., me numër *** kol., datë 13.4.2005, dhe të dhënat e pasurisë sipas lejes së legalizimit nr. ***, viti 2016, kufijtë, vendndodhja dhe të dhënat e pasurisë së llojit “banesë dhe truall/oborr” përputhen plotësisht, duke konkluduar kështu se bëhet fjalë për të njëjtën pasuri.

32.26 Për sa më sipër, subjekti ka shpjeguar se referuar aktmarrëveshjes nr. *** rep., nr. *** kol., datë 13.4.2005; deklaratës noteriale nr. *** rep., nr. *** kol., datë 9.11.2024; lejes së legalizimit nr. ***, të vitit 2016, për shtetasin P.H.D; planvendosjes së pasurisë; planit të rilevimit të pasurisë; aktit të ekspertimit topografik të hartuar nga ing. hartografë - rezultojnë të provuara faktet vijuese:

- Ekzistenca e sendit banesë njëkatëshe sipas përshkrimit në aktmarrëveshjen nr. *** rep., nr. *** kol., datë 13.4.2005, si dhe posedimin prej familjes B të kësaj banese;
- Ekzistenca e mundësisë financiare të bashkëshortëve A dhe Z.B për ndërtimin (krijimin) e këtij sendi. Mundësitë janë krijuar përmes kontratës nr. *** rep., nr. *** kol., datë 17.10.1998, përmes së cilës kanë shitur apartamentin që kishin në pronësi, të përfutur me privatizim, kundrejt çmimit 1.970.000 lekë;
- Tjetërsimin e sendit në gjendjen që ka qenë i palegalizuar, te blerësi P.D, i cili ka qenë në dijeni të këtij fakti dhe ka rënë dakord që ta blejë sendin, duke i dorëzuar palës shitëse çmimin e rënë dakord dhe duke marrë përsipër ndjekjen e procedurave administrative, deri në kalimin e plotë të pronësisë dhe legalizimin e sendit;
- Legalizimin e sendit nga blerësi P.D sipas lejes së legalizimit nr. ***, të vitit 2016;
- Përputhshmërinë e plotë të kufijve të sendit të përcaktuar në aktmarrëveshjen nr. *** rep., nr. *** kol., datë 13.4.2005, me kufijtë e sendit të përcaktuar në lejen e legalizimit në emër të shtetasit P.D, duke u konfirmuar se bëhet fjalë për të njëjtin send;
- Likuidimin e plotë të çmimit të shitjes, në shumën 4.300.000 lekë, nga blerësi P.D, te shitësja Z.B. Ky fakt provohet jo vetëm përmes aktmarrëveshjes së vitit 2005, por edhe përmes deklaratës noteriale të vitit 2024, lëshuar nga shtetasi P.D, i cili ka konfirmuar se shuma është dhënë e plotë në momentin kur është dorëzuar sendi sipas aktmarrëveshjes.

32.27 Në lidhje me përdorimin e vlerës korresponduese të çmimit të shitjes së banesës njëkatëshe për blerjen e automjetit, sipas deklaratës *Vetting* subjekti ka shpjeguar se nëna e E.B, shtetasja Z. B, ka depozituar *cash*, pa përshkrim, në bankën “OTP Bank Albania” sh.a., shumat: i) 690.000 lekë, depozituar më 22.8.2005, tërhequr me disa këste, deri më 24.11.2005 dhe ii) shumën 1.400.000 lekë, depozituar më 18.8.2006, tërhequr më 30.8.2006. Gjithashtu, në llogarinë e znj. Z.B, në bankën “Raiffeisen Bank” sh. a., është kryer depozitim *cash* i shumës 950.000 lekë më 11.9.2006. Shuma është mbajtur si depozitë, deri kur është tërhequr më 15.3.2007.

Znj. Z.B i ka depozituar shumat e sipërpërmendura në harkun kohor 22.8.2005 – 11.9.2006, periudhë që është pas tjetërsimit të sendit banesë njëkatëshe, sipas aktmarrëveshjes nr. rep. ***, nr. *** kol., datë 13.4.2005.

32.28 Me të drejtë, Komisioni ka konstatuar se nuk identifikohet ndonjë transaksion bankar apo mandatpagesë për shitjen e shtëpisë njëkatëshe. Kjo sepse çmimi për shitjen e banesës është dorëzuar me para në dorë. Fakt i konfirmuar nga blerësi P.D, sipas deklaratës noteriale të datës 9.11.2024. Kalimi i çmimit nuk është bërë nëpërmjet sistemit bankar.

32.29 Subjekti ka shpjeguar se është pikërisht kjo shumë monetare, e përfituar në dy këste nga znj. Z.B, që është depozituar nga kjo e fundit pranë bankave, në periudhën 2005 – 2006. Gjithashtu, ka rëndësi të mos lihet pa u vënë në dukje se referuar aktmarrëveshjes nr. *** rep., nr. *** kol., datë 13.4.2005, pavarësisht se në pjesën hyrëse të saj pasqyrohet si shitëse vetëm Z.B, në fund kanë nënshkruar si shitës edhe fëmijët e A dhe Z.B, konkretisht M.B (vajza), A.B (djali i madh) dhe E. B (djali i vogël). Sendi, sikurse me të drejtë është konstatuar nga Komisioni, nuk ka qenë në pronësi të palës shitëse. Kjo e fundit ka qenë poseduese dhe tjetërsimi i sendit është bërë nga poseduesit, duke u pranuar nga blerësi (përfituesi i posedimit).

32.30 Shuma monetare e përfituar nga tjetërsimi i sendit, në total 4.300.000 lekë, është ndarë mes anëtarëve të familjes. A.B ka përfituar $\frac{1}{4}$ -ën, ndërsa Z.B dhe E.B $\frac{3}{4}$ -ën, bashkërisht. E ka jetuar në mënyrë të vazhdueshme me nënën Z, deri në momenti që ajo është ndarë nga jeta. M.B, pavarësisht se ka marrë pjesë në shitjen e sendit, duke qenë se ishte e martuar dhe kishte banesë me bashkëshortin, si dhe për të mos rënduar financiarisht të ëmën, e cila ka pasur probleme të rënda shëndetësore (paralizë në anësitë e poshtme), nuk ka pranuar të marrë pjesë nga shuma e shitjes.

32.31 Nëse mblidhen shumat monetare të depozituara nga shtetasja Z.B në sistemin bankar, përgjatë viteve 2005 dhe 2006, pra 690.000 lekë (depozituar në “OTP Bank Albania” sh.a. më 22.8.2005) + 1.400.000 lekë (depozituar në “OTP Bank Albania” sh.a. më 18.8.2006) + 950.000 lekë (depozituar në “Raiffeisen Bank” sh.a. më 11.9.2006), totali është 3.040.000 lekë, shumë që përkon me $\frac{3}{4}$ -ën e shumës së çmimit të shitjes së mbajtur bashkërisht nga znj. Z.B dhe i biri E.B. Gjithashtu, subjekti ka shpjeguar se Z.B dhe E.B nuk rezulton të kenë blerë ndonjë send tjetër pas përfitimit të kësaj shume. Shumat monetare të përdorura për blerjen e automjetit burojnë pikërisht nga shuma monetare e përfituar nga shitja e banesës njëkatëshe. Nënë dhe bir kanë jetuar së bashku për shumë vite.

32.32 Për sa më sipër, duke marrë në analizë provat, faktet, kohën kur janë kryer veprimet juridike, si dhe rrethanat familjare të personave të përfshira në këto veprime, provohet se znj. Z.B dhe z. E.B kanë përfituar $\frac{3}{4}$ -ën e shumës monetare të përfituar nga tjetërsimi i banesës njëkatëshe, të cilën e kanë depozituar në sistemin bankar.

32.33 Për sa është trajtuar më sipër, subjekti ka shpjeguar se provohet që automjeti me targa të kokës së kamionit AA *** UX dhe me targa të rimorkios AFR*** është blerë nga bashkëshorti E.B me shumën monetare të përfituar prej tij dhe nënës së tij Z.B, nga tjetërsimi i pasurisë banesë njëkatëshe, sipas aktmarrëveshjes nr. *** rep., nr. *** kol., datë 13.4.2005, te blerësi P.D.

Vlerësimi i Komisionit

32.34 Pas analizimit të shpjegimeve të subjektit të rivlerësimit, si dhe të dokumentacionit të administruar, trupi gjykues vlerësoi rrethanat vijuese se:

- Nga hetimi i Komisionit nuk rezultoi ndonjë e dhënë që subjekti i rivlerësimit Marjola Beluli të mund të kish kontribuar në krijimin e pasurive të ish-bashkëshortit;
- Automjeti i blerë nga E.B në datën 25.3.2014 i takon periudhës përpara se të martohet me subjektin e rivlerësimit. Martesa mes E.B dhe Marjola Belulit është lidhur më 24.10.2014, dhe kjo pasuri për të cilën subjektin iu kalua barra e provës, është krijuar në datën 25.3.2014;
- Ky automjet është blerë nga z. E.B përpara se subjekti të emërohet në detyrën e ndihmëses ligjore pranë ish-Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Vlorë, më 16.6.2015.

32.35 Referuar barrës së provës që i është kaluar subjektit nga Komisioni, për burimin e krijimit të automjetit, që z. E.B ka deklaruar se është krijuar nga të ardhurat e përfituara sipas aktmarrëveshjes “Për shitjen e pasurisë së paluajtshme banesë 1-katëshe” me nr. *** rep., nr. *** kol., e datës 13.4.2005, me aktet e depozituara nga subjekti u provua:

- Ekzistenca e sendit banesë njëkatëshe dhe posedimi i saj prej familjes B, e cila ka shërbyer si burim financiar për krijimin e automjetit, si dhe tjetërsimi i këtij sendi, të palegalizuar, të blerësi P.D, në këmbim të çmimit të blerjes;
- Legalizimi i këtij sendi në emër të blerësit P.D, sipas lejes së legalizimit nr. ***, viti 2016;
- Përputhshmëria e plotë e kufijve të sendit të përcaktuar në aktmarrëveshjen nr. *** rep., nr. *** kol., datë 13.4.2005, me kufijtë e sendit të përcaktuar në lejen e legalizimit në emër të shtetasit P.D, duke u konfirmuar se bëhet fjalë për të njëjtin send;
- Likuidimi i çmimit të shitjes në shumën 4.300.000 (katër milion e treqind mijë) lekë nga pala blerëse P.D tek ajo shitëse Z.B, shumë e cila i është paguar *cash*, jashtë sistemit bankar.

32.36 Në përfundim, pas analizimit të akteve e provave shtesë, si dhe të shpjegimeve të subjektit, depozituar pas kalimit të barrës së provës, Komisioni kreu analizën financiare për z. E.B, nga ku rezultoi me gjendje pozitive dhe se ka pasur burime të mjaftueshme financiare për të blerë automjetin e deklaruar prej tij, duke konkluduar përfundimisht se subjekti ka arritur të përmbysë barrën e provës të kaluar nga Komisioni.

Analiza financiare për periudhën e rivlerësimit, vitet 2015 – 2016

PERSHKRIMI	2015	2016
PASURI	-100 495	600 818
<i>Shtesa/Pakesime likuiditete</i>	<i>(100 495)</i>	<i>600 818</i>
Likuiditete Gjendje	(100 495)	500 323
DETYRIME	-	700 000
Kredi Tirana Bank 16.12.2016		700 000
PASURI NETO = Pasuri - Detyrime	(100 495)	(99 182)
TE ARDHURA	676 893	762 132
Te ardhura nga paga e subjektit	676 893	762 132
SHPENZIME	224 276	435 092
Shpenzime jetese	224 276	235 092
Shpenzime mjekesore		200 000
REZULTATI	553 112	426 222

- ✓ Analiza financiare për periudhën kur subjekti ka ushtruar detyrën e ndihmësës ligjore, ka rezultuar me balanca pozitive.

Konkluzion përfundimtar mbi pasurinë

32.37 Nga vlerësimi në tërësi i deklarimeve në deklaratën *Vetting* ka rezultuar se subjekti i rivlerësimit ka deklaruar saktë pasuritë, si dhe nuk janë konstatuar elemente, që mund të ngrenë dyshime për fshehje pasurie apo deklarim të rremë.

32.38 Nga analizimi i të ardhurave të dokumentuara ka rezultuar se subjekti i rivlerësimit dhe ish-bashkëshorti i saj kanë disponuar burime të ligjshme për krijimin e pasurive dhe mbulimin e shpenzimeve për të gjithë periudhën e rivlerësimit. Subjekti nuk rezultoi të ketë qenë në kushtet e konfliktit të interesit të parashikuar në ligj. Në përfundim të procesit të rivlerësimit, referuar nenit D të Aneksit të Kushtetutës dhe dispozitave të kreut IV të ligjit nr. 84/2016, Komisioni krijoi bindjen se subjekti i rivlerësimit Marjola Beluli ka arritur një nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë.

B. KONTROLLI I FIGURËS

33. AKSIK-ja ka kryer kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit me anë të verifikimit të deklarimeve dhe të dhënave të tjera, me qëllim që të identifikojë nëse subjekti i rivlerësimit ka kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës dhe ligjit nr. 84/2016.

33.1 AKSIK-ja ka dërguar raportin në përputhje me nenin 39 të ligjit nr. 84/2016¹⁰ mbi kontrollin e figurës për subjektin e rivlerësimit, ku ka konstatuar përshtatshmërinë e subjektit të rivlerësimit Marjola Beluli në detyrën e ndihmëses ligjore.

Vlerësimi i Komisionit

33.2 Komisioni ka kërkuar përditësim të raportit të dërguar nga AKSIK-ja të vitit 2017, për të cilin nuk kemi marrë informacion shtesë.

33.3 Komisioni, si organ i legjitimuar nga Kushtetuta dhe ligji nr. 84/2016 për të bërë rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë, ka hetuar në mënyrë të pavarur çdo informacion dhe konkluzion të institucionit të sipërpërmendur, ashtu sikurse të gjitha faktet dhe informacionet e marra nga çdo subjekt i së drejtës, në përputhje me nenet 45, 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016.

33.4 Në përfundim të rivlerësimit për kriterin e kontrollit të figurës, Komisionit i rezulton se subjekti i rivlerësimit, znj. Marjola Beluli, arrin nivel të besueshëm në kontrollin e figurës, sipas parashikimit të nenit 59/1, shkronja “b”, të ligjit nr. 84/2016, pasi nga verifikimet e kryera nuk rezultoi se ka kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar, ka dorëzuar në kohë deklaratën për figurën, si dhe nuk ka bërë deklaramë të pasakta ose nuk ka fshehur kontakte me persona të përfshirë në krimin e organizuar.

C. VLERËSIMI I AFTËSIVE PROFESIONALE

34. Hetimi i Komisionit lidhur me këtë kriter është bazuar në analizimin e:

- raportit të hartuar nga KLGJ-ja¹¹ për analizimin e aftësive profesionale të subjektit të rivlerësimit;
- kritereve të vlerësimit.

34.1 Ky raport i ka analizuar të dhënat e rezultuara nga dokumentet, duke iu referuar kritereve të mëposhtme të vlerësimit:

- a. aftësive profesionale;
- b. aftësive organizative;
- c. etikës dhe angazhimit ndaj vlerave profesionale;
- ç. aftësive personale dhe angazhimit profesional.

34.2 Ky raport është hartuar bazuar në përshkrimin dhe analizimin e formularit të vetëdeklarimit, të 3 dokumenteve ligjore të përzgjedhura nga vetë subjekti i rivlerësimit, si dhe të dhënave e dokumenteve të tjera që shoqërojnë formularin e vetëdeklarimit, që janë paraqitur nga vetë subjekti i rivlerësimit.

¹⁰ Raporti mbi kontrollin e figurës për subjektin, me nr. *** prot., datë 2.11.2017, deklasifikuar plotësisht me vendimin e KDZH-së nr. ***, datë 17.8.2023.

¹¹ Me nr. *** prot., datë 29.10.2024.

Gjetjet nga formulari i vetëdeklarimit dhe dokumentet e paraqitura nga vetë subjekti i rivlerësimit

34.3 Subjekti i rivlerësimit, ndihmësja ligjore Marjola Beluli, në datën 27.1.2017 ka paraqitur në Këshillin e Lartë të Drejtësisë aktet vijuese:

- formularin e vetëdeklarimit, gjithsej 5 fletë;
- 15 dokumente shoqëruese të formularit të vetëdeklarimit, gjithsej 40 fletë.

34.4 Nga analiza e dokumentacionit të paraqitur nga vetë subjekti i rivlerësimit, konstatohet se formulari paraqitet i plotë dhe i nënshkruar, pa kundërthënie e sipas shtojcës që parashikon ligji.

Përvoja profesionale në dhjetë vitet e fundit

34.5 Sipas të dhënave të deklaruara në rubrikën “B” të formularit, për periudhën janar 2008 deri në qershor 2015 subjekti ka deklaruar se ka qenë e punësuar si sekretare gjyqësore në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Vlorë, ndërsa në qershor të vitit 2015 ajo është emëruar ndihmëse ligjore pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Vlorë.

34.6 Nga aktet e paraqitura nga vetë subjekti i rivlerësimit, rezulton se si ndihmëse ligjore ajo ka vazhduar deri në muajin shtator të vitit 2017, kohë në të cilën ajo është shpallur fituese si kandidate për magjistrate dhe ka nisur studimet pranë Shkollës së Magjistraturës. Në përfundim të studimeve, me vendimin e Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. ***, datë 20.10.2020 ajo është emëruar Gjyqtare në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Përmet.

Detyrat e kryera tri vitet e fundit dhe të dhënat statistikore

34.7 Subjekti i rivlerësimit Marjola Beluli ka deklaruar se nga data 18.6.2015 deri në fundin e shtatorit të vitit 2017 ka punuar në fushën e së drejtës administrative, në detyrën e ndihmësës ligjore në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Vlorë, si dhe ka deklaruar këto të dhëna, pa paraqitur ndonjë shkresë shoqëruese:

Në periudhën qershor 2015 – shtator 2017 i janë caktuar 1169 çështje dhe ka përfunduar 1169 çështje administrative

Trajnimet në tri vitet e fundit

34.8 Subjekti i rivlerësimit Marjola Beluli ka deklaruar se ka marrë pjesë në katër trajnime në programin e formimit vazhdues të Shkollës së Magjistraturës, duke bashkëlidhur edhe tri certifikatat përkatëse.

Tri dokumentet ligjore të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit

34.9 Nga 3 dokumentet e depozituara nuk u konstatuan problematika lidhur me vlerësimin profesional të subjektit të rivlerësimit Marjola Beluli në cilësinë e ndihmësës ligjore.

TË DHËNA NGA BURIME ARKIVORE TË KLGJ-së

34.10 Subjekti i rivlerësimit Marjola Beluli nuk ka të dhëna në burimet arkivore të KLGJ-së për periudhën e rivlerësimit, për shkak të detyrës si ndihmëse ligjore që ajo ka ushtruar në këtë periudhë në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Vlorë.

ANALIZA E GJETJEVE

34.11 Analiza e gjetjeve u referohet të dhënave të nxjerra nga dy grupet e burimeve të informacionit: (i) formularit të vetëvlerësimit dhe dokumentacionit të paraqitur nga vetë subjekti; (ii) tri dokumenteve ligjore të përzgjedhura dhe të paraqitura prej saj.

Aftësitë profesionale

a) Njohuritë ligjore

34.12 Procesi i rivlerësimit kalimtar të ndihmësve ligjorë pranë gjykatave administrative parashikohet dhe rregullohet nga neni 42, pika 2 e ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, si dhe nga neni 165 i ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”. Kështu, në nenin 165, pika 1 e ligjit nr. 96/2016, parashikohet se: *“Këshilltari i gjyqtarit pranë Gjykatës Kushtetuese dhe Gjykatës së Lartë, ndihmësi ligjor pranë Prokurorisë së Përgjithshme dhe në gjykatat administrative, si dhe inspektori në Këshillin e Lartë të Drejtësisë, që nuk gëzon statusin e gjyqtarit ose prokurorit, janë subjekt i procesit të rivlerësimit, në përputhje me ligjin “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.*

Ndërkohë neni 42, pika 2 e ligjit nr. 84/2016 parashikon se: *“Këshilltari Ligjor i Gjykatës Kushtetuese, ndihmësi ligjor i Gjykatës së Lartë, Gjykatës Administrative, si dhe ndihmësi ligjor në Prokurorinë e Përgjithshme, të cilët nuk janë magjistratë, vlerësohen bazuar në: a) relacionet dhe mendimet ligjore të përgatitura; b) rezultatet e testimin pranë Shkollës së Magjistraturës*

34.13 Referuar parashikimeve ligjore e nënligjore në fuqi për kohën kur kryhet ky proces rivlerësimi profesional, për ndihmësit ligjorë, ndryshe nga magjistratët-gjyqtarë, nuk ka pasur të miratuar nga një organ kompetent një sistem vlerësimi profesional.

34.14 Për rrjedhojë, për ndihmësit ligjorë në gjykatat administrative nuk ka kritere matëse të punës, sikurse kanë ekzistuar për magjistratët-gjyqtarë, prandaj vlerësimi i aftësive profesionale të tyre nuk ndjek detyrimisht të njëjtat rregulla sikurse për magjistratët-gjyqtarë.

Në këto kushte, vlerësimi i aftësive profesionale të ndihmësve ligjorë pranë gjykatave administrative do të kryhet në përputhje me parashikimin e nenit 42, pika 2 e ligjit nr. 84/2016 të sipërcituar, si dhe bazuar në përmbajtjen e nenit 6, pika 2 e ligjit nr. 49/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar.

34.15 Subjekti i rivlerësimit Marjola Beluli ka filluar punë si ndihmëse ligjore pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Vlorë, pas emërimit të saj me vendimin e datës 18.6.2015 të kryetarit të Gjykatës. Në periudhën objekt i rivlerësimit kalimtar (8.10.2013 – 8.10.2016), znj. Beluli ka ushtruar detyrën e ndihmësve ligjore në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Vlorë nga data 18.6.2015 – 8.10.2016, për 1 vit e katër muaj. Referuar parashikimit të nenit 41, pika 3 e ligjit nr. 84/2016, në rast se subjekti i rivlerësimit ka më pak se tri vite në detyrë, periudha e vlerësimit konsiderohet e gjithë koha gjatë ushtrimit të detyrës, pra deri më 3.10.2017.

34.16 Ndërkohë, para emërimit në detyrën e ndihmësit ligjor pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, znj. Marjola Beluli për periudhën janar 2008 – qershor 2015, ka deklaruar

se ka qenë e punësuar si sekretare gjyqësore në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Vlorë dhe në qershor të vitit 2015 është emëruar ndihmëse ligjore pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Vlorë. Ka vijuar detyrën e ndihmëses ligjore në këtë gjykatë deri në shtator të vitit 2017, kohë në të cilën është shpallur fituese si kandidate për magjistrate dhe ka nisur studimet pranë Shkollës së Magjistraturës. Në përfundim të studimeve, me vendimin e Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. ***, datë 20.10.2020, ajo është emëruar gjyqtare, detyrë të cilën aktualisht e ushtron në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës.

34.17 Ndhimësi ligjor është njësi ndihmëse, pjesë e organizimit të brendshëm të gjykatave administrative. Në nenin 6, pika 1 e ligjit nr. 49/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative” përcaktohet se: *“Gjyqtari i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë dhe Gjykatës Administrative të Apelit në veprimtarinë e tij ndihmohet nga ndihmësi ligjor.”*

34.18 Në nenin 6, pika 2 e ligjit nr. 49/2012, detajohen detyrat e ndihmësit ligjor, ku shprehimisht thuhet: *“Ndhimësi ligjor ndihmon dhe këshillon gjyqtarin lidhur me përgatitjen e çështjes për gjykim dhe shqyrtimin gjyqësor, si dhe përgatit projektakte procedurale të nevojshme për gjykimin. Me kërkesë të gjyqtarit, ndihmësi ligjor bën kërkitime ligjore dhe përgatit opinione me shkrim për problematika ligjore të karakterit procedural dhe material që lidhen me çështjet në gjykim”.* Vlerësimi i aftësive profesionale të ndihmësve ligjorë në gjykatat administrative, përfshirë këtu subjektin e rivlerësimit Marjola Beluli, do mbështetet edhe në parashikimin ligjor të sipërcituar, pra në nenin 6, pika 2 e ligjit nr. 49/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative....”

Vlerësimi i aftësive profesionale të subjektit të rivlerësimit Marjola Beluli, në cilësinë e ndihmëses ligjore, bazuar në 3 dokumentet ligjore të prezantuara nga vetë znj. Marjola Beluli

34.19 Tri dokumentet ligjore të prezantuara nga znj. Marjola Beluli kanë formën dhe përmbajtjen e një draft-vendimi gjyqësor. Pasi kemi analizuar përmbajtjen e secilit prej tyre, konkludojmë se projektvendimet e hartuara nga ndihmësja Marjola Beluli, nga forma, por edhe përmbajtja e tyre në tërësi përmbajnë elementet e vendimeve gjyqësore përfundimtare.

34.20 Ndhimësi ligjor ka relatuar mosmarrëveshjet objekt gjykimi, palët ndërgjyqëse, pretendimet dhe prapësimet e palëve ndërgjyqëse. Faktet shoqërohen me provat prej nga ato rezultuan. Jepet përgjigje e arsyetuar për pretendimet dhe prapësimet e palëve.

Janë parashtruar nga ana e ndihmëses ligjore rrethanat e çështjes dhe provat e administruara në dosjen gjyqësore lidhur me marrëdhënien juridiko-civile. Gjithashtu, nga ana e ndihmëses ligjore është përshkruar arsyetimi dhe vlerësimi i saj për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve, ku janë analizuar rrethanat e fakteve të cilësuar.

34.21 Projektvendimet rezultojnë të jenë përgatitur dhe përpiluar në përputhje me parashikimet e nenit 6, pika 2 e ligjit nr. 49/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative”.

Vlerësojmë se projektvendimet e përgatitura nga ndihmësja ligjore Marjola Beluli kanë shërbyer si një bazë e mirë për zgjidhjen e çështjes nga ana e gjyqtarit përkatës.

34.22 Sa i përket kriterit tjetër të vlerësimit, të parashikuar nga neni 42, pika 2 e ligjit nr. 84/2016 “Rezultatet e testimit pranë Shkollës së Magjistraturës”, nga lista e pjesëmarrësve të këtij testimi, të shpallur nga Këshilli Drejtues i Shkollës së Magjistraturës, me vendimin nr. **, datë 21.5.2018, rezulton se subjekti Marjola Beluli nuk ka marrë pjesë, por kjo për faktin se në periudhën 2017 – 2020 ajo ka qenë studente, duke ndjekur studimet pranë kësaj shkolle si kandidate për magjistrate.

Aftësitë organizative

a) Aftësia për të përballuar ngarkesën në punë

34.23 Subjekti i rivlerësimit Marjola Beluli rezulton se ka ushtruar detyrën e ndihmësës ligjore pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Vlorë, nga data e emërimit të saj 18.6.2015 deri më 30.9.2017, kur ka nisur studimet në Shkollën e Magjistraturës. Në funksionin e ndihmësës ligjore pranë kësaj gjykate, ajo ka deklaruar se në periudhën 18.6.2015 – 30.9.2017 i janë caktuar 1169 çështje dhe ka përfunduar 1169 çështje, të kërkuara nga gjyqtarët që ajo ka asistuar. Këto të dhëna statistikore janë të deklaruara nga vetë subjekti në formularin e vetëvlerësimit profesional.

Duhet evidentuar fakti se për subjektin e rivlerësimit nuk ka të dhëna direkte për ngarkesën dhe punën e saj, por kuadri ligjor në fuqi për kohën kur kryhet ky vlerësim profesional, nuk përcakton standarde minimale pune për ndihmësin ligjor të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë.

Nga të dhënat statistikore të deklaruara nga vetë ndihmësja ligjore Marjola Beluli mund të themi se subjekti i rivlerësimit ka përballuar një ngarkesë të lartë pune dhe ka përfunduar në kohë detyrat e ngarkuara nga gjyqtarët asistues. Subjekti i rivlerësimit ka asistuar në të njëjtën kohë disa gjyqtarë, ku secili prej tyre ka shpallur një numër të lartë vendimesh gjyqësore.

b) Aftësia për të kryer procedurat gjyqësore

34.24 Referuar dispozitave ligjore¹², rezulton qartë se ndihmësi ligjor nuk kryen procedura gjyqësore. Ky kriter vlerësimi shërben dhe zbatohet vetëm për gjyqtarin, i cili ka të përcaktuara qartësisht në ligj detyrat e tij procedurale, duke filluar që nga marrja me short e çështjes e deri në përfundimin e saj me vendim përfundimtar.

c) Aftësia për të administruar dosjet

34.25 Edhe ky kriter vlerësimi zbatohet vetëm për gjyqtarët. As në ligjin nr. 49/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative” dhe në asnjë ligj apo akt nënligjor tjetër nuk parashikohet si detyrë për ndihmësin që të administrojë një dosje gjyqësore.

Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale

a) Etika në punë

¹² Detyrat e ndihmësit ligjor të gjykatave administrative janë parashikuar në nenin 6 të ligjit nr. 49/2012 dhe konkretisht në paragrafin 1 e 2 të tij, ku sanksionohet se: “1. Gjyqtari i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë dhe i Gjykatës Administrative të Apelit në veprimtarinë e tij ndihmohet nga ndihmësi ligjor. 2. Ndihmësi ligjor ndihmon dhe këshillon gjyqtarin lidhur me përgatitjen e çështjes për gjykim dhe shqyrtimin gjyqësor, si dhe përgatit projektakte procedurale të nevojshme për gjykimin. Me kërkesë të gjyqtarit, ndihmësi ligjor bën kërkime ligjore dhe përgatit opinione me shkrim për problematika ligjore të karakterit procedural dhe material që lidhen me çështjet në gjykim”.

34.26 Ndhmësi ligjor, për shkak të natyrës së punës, nuk ka kontakte me palët ndërgjyqëse, pasi nuk merr pjesë në seancë gjyqësore, por për subjektin e rivlerësimit Marjola Beluli gjatë periudhës së rivlerësimit nuk rezulton të ketë pasur ndonjë masë disiplinore.

b) Integriteti

34.27 Nga të dhënat e deklaruara nga subjekti i rivlerësimit Marjola Beluli dhe nga dokumentet ligjore të vëzhguara, konstatohet se nuk kanë dalë të dhëna në lidhje me imunitetin e saj ndaj çdo ndikimi apo presioni të jashtëm.

c) Paanësia

34.28 Ky element vlerësues është tipik për gjyqtarin, i cili ka detyrimin ligjor jo vetëm të jetë i paanshëm në një proces gjyqësor, por edhe të sillet si i tillë sipas parimit “Drejtësia jo vetëm duhet të jepet, por edhe të shihet se jepet”.

Ndhmësi ligjor nuk ka kontakte me palët ndërgjyqëse, pasi nuk është pjesëmarrës në një proces gjyqësor dhe as subjekt procedural. Ndhmësi ligjor nuk është organ vendimmarrës, por këshillues dhe asistues i gjyqtarit. Në tri projektvendimet e përgatitura dhe të paraqitura nga ndihmësja ligjore Marjola Beluli nuk konstatohen elemente favorizuese apo njëanshmërie në raport me palët ndërgjyqëse pjesëmarrëse në ato procese gjyqësore që u përkasin projektvendimet.

Aftësitë personale dhe angazhimi profesional

a) Aftësitë e komunikimit

34.29 Rezultoi se znj. Marjola Beluli ka filluar punë si ndihmëse ligjore pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Vlorë me vendimin e datës 18.6.2015 të kryetarit të asaj gjykate. Në të tria dokumentet ligjore nuk ka të dhëna për mënyrën e komunikimit të subjektit të rivlerësimit Marjola Beluli me palët ndërgjyqëse, pasi për shkak të natyrës së punës ajo nuk ka kontakt me ta, ndërsa gjuha e përdorur në aktet e përpiluara prej saj mund të vlerësohet si korrekte dhe normale.

b) Aftësia për të bashkëpunuar

34.30 Në të tria dokumentet ligjore nuk janë konstatuar të dhëna specifike mbi aftësinë e subjektit të rivlerësimit për të bashkëpunuar me gjyqtarët, me kolegët e tyre dhe administratën gjyqësore, si dhe nëse subjekti ka shkëmbyer njohuri apo përvojë profesionale me ta, por nuk evidentohet problematikë në bashkëveprimin e saj me gjyqtarët, të cilët ka asistuar.

c) Gatishmëria për t'u angazhuar

34.31 Nga aktet e paraqitura nga vetë subjekti i rivlerësimit, rezulton se si ndihmëse ligjore ajo ka vazhduar deri në muajin shtator të vitit 2017, kohë në të cilën është shpallur fituese si kandidate për magjistrate dhe ka nisur studimet pranë Shkollës së Magjistraturës. Në përfundim të studimeve, me vendimin e Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. **, datë 20.10.2020, ajo është emëruar gjyqtare, detyrë të cilën e ushtron edhe aktualisht.

Denoncime lidhur me ushtrimin e detyrës si gjyqtare

34.32 Për subjektin e rivlerësimit Marjola Beluli janë depozituar 3 denoncime¹³ nga shtetasi V.Ç. Ky shtetas ka paraqitur disa denoncime për subjektin e rivlerësimit Marjola Beluli si gjyqtare dhe kryetare e Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Gjyrokastër për shkaqe korrupsioni. Ky denoncues ka bashkëlidhur disa akte, nga të cilat rezulton se ka qenë kërkues në një proces civil, në Gjykatën e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Gjyrokastër, dhe subjekti Marjola Beluli, në cilësinë e gjyqtarës së çështjes, ka vendosur kthimin e akteve të çështjes civile për të meta të padisë.

34.33 Pretendimet e denoncuesit lidhen me themelin e çështjes, pasi nuk është dakord me vendimmarrjen e subjektit të rivlerësimit. Vendimet e gjykatave mund të ankimohen në shkallën më të lartë të gjyqësorit dhe nuk janë objekt shqyrtimi nga ana e Komisionit.

34.34 Referuar nenit 53 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, vlerësohet se ky denoncim nuk përmban fakte apo rrethana që mund të përbëjnë prova në lidhje me kriteret e rivlerësimit për subjektin e rivlerësimit.

Konkluzion lidhur me kriterin e vlerësimit të aftësive profesionale

34.35 Nga hetimi i thellë administrativ i kryer nga Komisioni nuk u provua asnjë indicie apo element që cenon kriterin profesional të ndihmësës ligjore/aktualisht gjyqtare, znj. Marjola Beluli dhe, sipas parashikimeve të nenit 44/a të ligjit nr. 84/2016, subjekti i rivlerësimit ka treguar cilësi të pranueshme në punë, është efektive dhe efiçente në masë të pranueshme dhe, përfundimisht, u vlerësua për kriterin profesional “e aftë”.

KONKLuzion Përfundimtar

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, pasi u njoh me rrethanat e çështjes, bazuar në provat e administruara, raportin dhe rekomandimet e relatores së çështjes, si dhe pasi dëgjoi subjektin në seancën dëgjimore publike, arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit Marjola Beluli ka plotësuar së bashku kushtet e mëposhtme:

- a. ka arritur nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë;
- b. ka arritur nivel të besueshëm në kontrollin e figurës;
- c. ka arritur nivel kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale.

PËR KËTO ARSYE,

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, bazuar në pikën 5 të nenit 55 të ligjit nr. 84/2016, pasi u mblodh në dhomë këshillimi, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar dhe në bazë të shkronjës “a” të pikës 1 të nenit 58, si dhe të pikës 1 të nenit 59 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”,

¹³ Me nr. *** prot., datë 6.6.2024, nr. *** prot., datë 2.5.2024 dhe nr. *** prot., datë 23.5.2024.

V E N D O S I:

1. Konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit Marjola Beluli, ndihmëse ligjore në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Vlorë, aktualisht gjyqtare në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës.
2. Ky vendim i arsyetuar me shkrim u njoftohet subjektit të rivlerësimit, Komisionerit Publik dhe vëzhguesve ndërkombëtarë, si dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit, në përputhje me pikën 7 të nenit 55 të ligjit nr. 84/2016.
3. Ky vendim mund të ankimohet në Kolegjin e Posaçëm të Apelit nga subjekti i rivlerësimit dhe/ose Komisioneri Publik brenda 15 ditëve nga data e njoftimit të vendimit.
4. Ankimi depozitohet në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit.
Ky vendim u shpall në Tiranë, më 21.11.2024.

ANËTARËT E TRUPIT GJYKUES

Olsi KOMICI
Kryesues

Suela ZHEGU
Relatore

Brunilda BEKTESHI
Anëtare

Sekretare gjyqësore
Etmonda Hoxha